



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 40, datë 24.06.2019

PËR DHËNIEN E PAGESËS SË PAAFTËSISË DHE INVALIDËVE TË PUNËS
PËR MUAJIN QERSHOR 2019, PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR
MUAJIN MAJ 2019, PËR MIRATIMIN E KOMPENSIMIT TË ÇMIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR KATEGORITË PËRFITUESE, PËR PERIUdhËN
MAJ 2019

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin nr. 9355 date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar; ligjin nr.8626 datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar; ligjin nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar; VKM nr.277 date 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar; VKM nr.31 datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar; VKM nr.618 date 07.09.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar" të ndryshuar; VKM nr.869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar; VKM nr.955 dt.07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar; VKM nr.10 date 31.01.2018 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e kriterëve të sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondeve të kushtëzuara për bllok ndihmën ekonomike dhe/ose me fondet e buxhetit vendor"; Udhëzimin nr.1 datë 02.02.2015 "Mbi zbatimin e vendimit nr.8 datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar; Udhëzimin nr.8 datë 25.2.2015 "Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike" i ndryshuar; Udhëzimin nr.3 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave" të ndryshuar; Udhëzimin nr.4 datë 17.02.2017 "Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar; pika 1 e Udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2017 "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%" të ndryshuar; Udhëzimin nr. 625 dt. 27.08.2018 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 31 dt 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit, para-

tetraplegjik” të ndryshuar; Udhëzimin nr. 626 dt. 27.08.2018 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 618 dt. 07.09.2006”; Udhëzimin nr. 627 dt. 27.08.2018 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277 dt. 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit” të ndryshuar; Udhëzimin Nr. 629, datë 27.8.2018 “Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal”, shkresës nr. 68/37 prot, datë 24.4.2019 për akordimin e fondeve limit për periudhën Maj-Qershor 2019 si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së pagesës së paaftësisë për muajin **Qershor 2019**, për 4216 persona me fond **54,273,341** lekë nga ku (energji elektrike dhe telefon aftësi e kufizuar, verbëri dhe tetraplegjik **1,148,376** lekë), përkatësisht sipas ndryshimeve mujore bashkëngjitur.
2. Bazuar në VKM nr. 869, datë 18.06.2008, për muajin **Qershor 2019** do të trajtohen në total **3370** invalidë pune me shtesë kempit me fond **10,704,500** lekë.
3. Përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, fondi i miratuar nga Drejtoria Rajonale për muajin Maj 2019 (**9,896,200**) lekë, dhe përzgjedhjen e familjeve në nevojë, 233 familje që do të trajtohen me shumën **593,740** për periudhën Maj 2019 sipas listës bashkëngjitur.
4. Miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, për kategoritë përfituese, gjatë periudhës Maj 2019, sipas listës bashkëngjitur.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 24.6.2019

Shpallur në datën 25.6.2019

Sekretar i këshillit

K R Y E T A R

Suel Hadri

Xhemal BUSHATI